# PARTNERITET ME MEDIAN
# NE LUFTEN ANTIKRIM

Fotoalbum nga Xhavit Shala



E HËNË, 14 MAJ 2001 — NGJARJE E DITËS — SHEKULLI 7

*Pesë trafikantët nga Fieri, Lushnja e Durrësi, gënjyen, përdhunuan dhe bënë pazarin për të shitur një 15- vjeçare*

Në foto: Lart, drejtori i policisë së Fierit, Xhavit Shala.
Djathtas, tutori i fëmijëve, Esat Kaja

**ARRESTIMI**

## Kapet tutori i fëmijëve lypësa

FIER - Por policia e qarkut ka arrestuar shtetasin Esat Kaja, i cili shfrytëzonte fëmijë të vegjël për të lypur në Itali. Ky shtetas, në bashkëpunim me dy të tjerë, (tashmë të identifikuar nga policia), nëpërmjet mashtrimit, përzgjidhnin fëmijë të vegjël, nga familje të varfra, të cilët në rrugë klandestine i çonin në Itali për të lypur. Të gjitha fitimet që realizonin fëmijët e vegjël kalonin në xhepat e tutorëve të tyre. Ky lloj skllavërie është shfrytëzuar vazhdimisht gjatë viteve të fundit nga monstra të krimit shqiptar, por për herë të parë një grup i tillë u zbulua dhe u godit nga policia e Fierit. Esat Kaja 37 vjeç, lindur e banues në fshatin Ardenicë (Lushnje) ka rënë në prangat e policisë pas denoncimit të një fëmije që kishte qenë viktimë e tij. Nga spjegimet e marra minorenit me iniciale A.R. nga Lushnja, që kishte lypur për këtë grup kriminal, rezultoi se kishte punuar si lypës në Itali për llogari të Esat Kajës. Nga ky aktivitet lypësit i takonin 12.5 milionë lireta, shumë të cilën ai e kishte siguruar duke lypur dhe ia kërkonte Esatit. Ky i fundit, pasi i kishte marrë të gjitha paratë e kishte kërcënuar minorenin se në qoftë se do t'i mbante dhe njëherë tjetër në banesë paratë pa ia dorëzuar Kajës, do ta vriste. Kurse minoreni tjetër A.TH. nga fshatrat e Fierit, ka spjeguar se edhe ai ka punuar si lypës në Milano pasi ishte rekrutuar nga një bashkëfshatar i tij, i cili e kishte dërguar tek Esat Kaja. Në Milano ata qëndronin në një vilë trekatëshe ku në katin e parë qëndronin pesë lypësa, kurse Esati me pjesëtarët e tjerë të grupit qëndronin në katin e sipërm. Është rasti i parë në Shqipëri që një trafikant i tillë bie në prangat e policisë. Të gjitha këto janë bërë publike sot në një konferencë shtypi nga drejtori i drejtorisë së policise Xhavit Shala.

V.Muça

Vladimir Muçaj

# Policia asgjëson celulën e trafikut të prostitutave

FIER – Policia ka arrestuar 5 anëtarët e njërit nga grupet e trafikut të prostitutave, duke arritur të zbërthejë të gjithë mekanizmin e funksionimit të tij. Pas një pune operative intensive, policia e Fierit ka arritur të realizojë një operacion model, duke goditur njëkohësisht në tre rrethe të vendit për të asgjë-

armë duke e shoqëruar në një ambient të një prej bazave të tyre, kurse në mbrëmje ndërrojnë banesë duke e përdhunuar në grup. Duke shfrytëzuar lidhjet e

QENDRA E PRITJES
DHE MBROJTJES VIKTIMAVE TE TRAFIKUT-FIER





## Ambjentet



Ja si funksionon qendra e pritjes dhe mbrojtjes së viktimave të trafikut në Fier

# Fier. Ja shifrat e trafikut të prostitucionit

**FIER** - E përuruar qysh në Shtator të vitit 2001, në Qendrën e Pritjes dhe Mbrojtjes së viktimave të Trafikut në Fier janë strehuar 35 femra, nga të cilat 32 kanë penalizuar tutorët e tyre. Sipas drejtuesve të policisë lokale, mësohet se kjo qendër e sponsorizuar nga bisnesmenë fierakë ka një kosto ditore një mijë dollarë në ditë.

Shqetësuese ende për këtë qendër mbetet numri i madh i vajzave që kërkojnë ndihmë, përballë numrit të vogël të penalizimit të tutorëve të tyre.

Sipas kolonelit Xhavit Shala, drejtorit të Policisë së Qarkut të Fierit, mësohet se gjatë vitit 2001 janë penalizuar 107 autorë, ndaj të cilëve Gjykata vetë për 53 prej tyre kanë dhënë vendime për sigurim arrest në burg, të cilët më pas janë lënë të lirë, ndërsa përqindja e të dënuarve nga gjykata është shumë e vogël.

Duke u shprehur me shifra konkrete, drejtues të Drejtorisë së Policisë së Qarkut të Fierit bëjnë të ditur,se vetë 8 përqind e tutorëve trafikantë janë dënuar nga drejtësia, ndërsa 92 përqind të tjerë janë lënë të lirë e të padënuar.

Gjatë vitit 2001, sipas policisë, mësohet se janë kapur në flagrancë 57 viktima nga të cilat 65 përqind kanë qenë të moshës 13-20 vjeç, 24 përqind kanë qenë të moshës 21-25 vjeç, 7 përqind kanë qenë të moshës 26-31 vjeç. Përsa i përket arsimimit të tyre, mësohet se 88 përqind e vajzave ishin me arsim 8-vjeçar, 12 përqind me arsim të mesëm, ndërsa 76 përqind e tyre kanë qenë



beqare dhe 24 përqind kanë qenë të martuara.

Të dhënat zyrtare të policisë tregojnë, se 61 përqind e tutorëve janë me banim në qytet, 39 përqind nga fshati, se 47 përqind e tutorëve janë të martuar, 53 përqind janë beqarë.

Sipas kolonel Xhavit Shalës mësohet, se fondacionet e huaja i sigurojnë kësaj qendre një milion dollarë në vit, ndërsa kuota ditore e çdo viktime të trafikuar është 500 lekë të reja për ushqimin.

Aktualisht, në këtë qendër ndodhen 5 vajza, historia e të cilave është sa e ndryshme, aq dhe e njëjtë.

A. DAMINI

Fieri, qendër e rëndësishme e trafikut të femrave

# 24 të akuzuar për trafik prostitucioni

FIER - 24 persona janë penalizuar gjatë këtij viti nga policia e qarkut të Fierit, nën akuzën e trafikut të prostitucionit, ndërkohë që dy të tjerë janë shpallur në kërkim.

Drejtori i policisë të qarkut të Fierit, kolonel Xhavit Shala, tha për ATSH-në, se goditja e trafikantëve që mashtrojnë apo rrëmbejnë vajzat, me qëllim për t'i dërguar ato në Itali, ku i detyrojnë për të prostituar, është një nga prioritetet e punës së policisë.

"Strukturat e policisë, janë përfshirë në një veprimtari të gjerë, për të zbuluar të gjitha rastet e këtyre mashtrimeve apo të rrëmbimit forcërisht, duke goditur, veçanërisht, grupet që veprojnë në këtë fushë", nënvizoi Shala. Ai vuri në dukje, se si rezultat i kësaj pune është arritur, që 17 vajza të shkëputen nga rrjeti i këtij trafiku, duke i rikthyer ato në jetën normale, pranë familjeve të tyre.

Për të rritur efikasitetin e punës së policisë dhe e të gjitha strukturave ligjore ndaj trafikantëve, Kolonel Xhavit Shala, sugjeron që procedimi penal ndaj tyre, të fillojë edhe me denoncimin nga ana e prindërve. Sipas tij, ka ndodhur në mjaft raste kur denoncimet e vajzave, viktima të këtij trafiku, janë tërhequr pas presioneve dhe kërcënimeve të trafikantëve. Nga ana tjetër, sipas tij, është e domosdoshme që të krijohet institucioni i mbrojtjes së dëshmitarit.

## Zjarri djeg 10 hektarë ullishte

LUSHNJE - Ditën e dielë, rreth orës 14.00 në vendin e quajtur "Qafa e Sokolit" në Komunën e Dushkut fshati Thanasaj ka rënë një zjarr në ullishten e këtyre kodrave dhe janë djegur rreth 10 hektarë duke shkaktuar miliona lekë dëm ekonomik. Në vendngjarje shkuan menjëherë makinat e zjarrfikëseve dhe në bashkëpunim bllokimin dhe fikjen e tij.

Shkaku i zjarrit mendohet të jetë nga një pakujdesi e hedhjes së bishtave të cigareve të ndezura. Ky është rasti i dytë i shpërthimit të zjarrit në kodrat e këtij fshati gjatë kësaj stine të nxehtë vere.

A. D.

RD 21.08.2001

RILINDJA DEMOKRATIKE 21.08.2001

# Fier, operacioni antiprost

**Drejtoria e Policisë së Fierit bën publike punën 45 ditore të për goditjen e rrjeteve të trafikimit dhe të shfrytëzimit të femrave të detyruara me forcë të prostitucionë**

Drejtoria e Policisë së Fierit analizon punën e kryer në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore. Pas afro një muaji e gjysmë, që nga fillimi i zbatimit të planit strategjik për të goditur favorizuesit e prostitucionit e trafikut klandestin, përfundimet janë impresionuese. Në një hark kohor prej prej afro 45 ditësh janë evidentuar 12 raste me 30 autorë të identifikuar (18 të arrestuar dhe 12 në kërkim pasi janë jashtë Shqipërisë). Këta akuzohen për veprën penale të trafikut të femrave për ushtrim prostitucioni, ndërkohë që numri i përgjithshëm i të penalizuarve ka arritur që nga fillimi i vitit 2001 në shifrën 56. Si rrjedhojë e këtij ritmi të vazhdueshëm për të zbuluar, kapur dhe goditur trafikantët dhe bashkëpunëtorët e tyre është arritur që të shpëtojnë 13 viktima. Pothuaj të gjitha të mashtruara me anë të premtimit "do të martohemi". Sipas deklaratëve që kanë mbledhur agjentët e policisë, vajzat kanë përfunduar në rrugët apo klubet e natës së Italisë, Greqisë, Francës apo vendeve të tjera perëndimore, nën dhunën fizike dhe psiqike. "Një 21 vjeçareje nga Fieri, pasi i pret damarët e duarve duke e terrorizuar se do ta vriste, njeriu që i premtoi martesë por që u kthye në tutorin e saj, Aleksandër Fufi, e ka detyruar që të prostitunjë. Duke përfituar prej saj vetëm për pak ditë rreth 1.5 milionë lireta". Ndërsa 20 vjeçarja A.G. po nga ky qytet ishte rrëmbyer nga pretendenti i saj, Elir Murati, i cili e kishte përdhunuar bashkë me Bledar Zerajn, polic i FNSH-së, Fier. Këto janë vetëm dy nga historitë e trafikut njerëzor, i cili vetëm në dy muajt e fundit është goditur më tepër sesa gjatë gjithë vitit 1999. Por, sipas drejtuesve të Policisë së Fierit megjithë punën intensive të efektivave të kësaj drejtorie, problemi është më i gjerë. Në të gjitha rastet Policia Kriminale ka konstatuar se rrjetet e këtyre trafiqeve janë të shtrira në shumë rrethe të Shqipërisë. Në 12 rastet e trafiqeve, 8 autorë të tyre janë nga Fieri, ndërsa 3 nga Lushnja, 2 nga Mallakastra, 3 nga Berati e Elbasani, nga Tirana 5 autorë e të tjerë nga Durrësi, Vlora, Bulqiza, Tepelena, etj.

## Ditët antiprostitucion

**Në 8 shtator 2001.** Arrestohen në flagrancë: Kastriot Koka, Lavdosh Osmani dhe Filip e Aida Race, banorë të Tepelenës dhe të të Fierit. Gruaja u kishte mbushur mendjen dy motrave t'i dërgonte jashtë për "t'i martuar".

**10 shtator.** Ndalohet Vullnet Krasniqi, 24 vjeç, nga Barbullinja e Lushnjës. Nën premtimin se do të martohej me L.Xh., 23 vjeçe tentoi ta dërgonte atë në Itali.

**18 shtator.** Gentian Mubarremi, pasi kishte rrëmbyer qëllimisht 17 vjeçaren M.D. nga Vlora e kishte strehuar atë në banesën e Bujar Ramës, në Libofshë të Fierit. Autori është shpallur në kërkim.

**27 shtator.** Ndalohet 23 vjeçari Elir Murati nga Patosi dhe Bledar Zeraj, polic i FNSH, që kishin mashtruar e më pas përdhunuar një 19 vjeçare nga Fieri.

**8 tetor.** Arrestohet Armando Mitarja, 38 vjeç dhe Enver Vllahja, 20 vjeç, të dy nga Elbasani, pasi në bashkëpunim me 33 vjeçaren Zaide Liçaj kanë organizuar rrëmbimin e shtetases E.O. nga Librazhdi. Armando Mitarja jetonte në Itali me të vëllanë Valterin, i cili merret me trafikun e shfrytëzimin e femrave për prostitucion.

**14 tetor.** Dy prindër nga Bulqiza denoncojnë se vajza e tyre Sh.K. ishte shfrytëzuar në Greqi dhe më pas në Itali nga Kujtim Stafa e më pas nga Alfred Levanaj. Sa herë që kthehej në Rinas e priste "i vjehrri", që e niste sërish jashtë. Derisa Qemal Levanaj është arrestuar, ndërsa i biri është në kërkim.

**18 tetor.** Policia italiane kthen 21 vjeçaren E.K. së cilës "bashkëshorti" i ardhshëm, Aleksandër Fufi nga Mati, i kishte prerë damarët, për të detyruar që të prostitunte.

KORRIERI 28.10.2001

KORRIERI 28.10.2001

# Tutori filozof, prostitutë me skenar

**Si arriti Jerosimo Koja nga Kolonja e Lushnjes, të bindte të fejuarën të dilte në rrugë, për të prostituar. Në fillim luks, lajka e lutje, më tej me kërcënime dhe në fund duke i vënë korentin në vaskën me ujë. Historia e pabesueshme e "shtrimit të vajzës kryeneçe" që punoi për të 4 vjet**

Xhemil BEHARAJ

"Do të gruan. Ti më pëlqen. Do të shkojmë në Itali. Atje kam miq. Do të bëjmë jetë ëmdërrash", këto kishin qenë fjalët me të cilat Jerosimo Koja nga Kolonja e Lushnjes kishte mundur t'i merrte mendjen një vajze A. M. po nga fshati i vet. Dhe pasi ka mundur ta bindë, vërtet e ka çuar në Itali. Vërtet janë sistemuar në një shtëpi të mirë, vërtet kanë filluar të bëjnë qejf. Natyrisht që jeta në milano të Italisë vajzës i është dukur më e bukur, krahasuar me baltën e Myzeqesë, të cilën i fejuari ia përmendte shpesh. Por asnjëherë më parë nuk kishte dyshuar se ai po e mashtronte dhe se qëllimi ishte krejt tjetër. Madje ajo nuk arrinte të kuptonte se edhe jeta në luks, edhe shtëpia e bukur ishin pjesë e këtij qëllimi.

**"Mbarojnë paratë!"**

Ditët e para në Itali kishte edhe jetë nate. Tutori nga fshati Kolonjë i Lushnjes ishte edhe një farë psikologu. Vajza e padalë u mësua të shihte qejfet e rinisë nëpër lokale nate, video pornografike etj. Por në kulmin e një jete të tillë, në një moment të bukur Jerosimi lëshon mandatën: "Më mbaruan lekët! Po tani?" Detyrohen të lënë shtëpinë e bukur dhe të jetojnë në një dhomë të vetme me kushte aspak të ngjashme. Duke bërë një tnverie kan të madhe në bënte si gjithë të tjerat, pra të prostituonte, me qëllim që të jetonin si më parë. "Mund ta bësh në hotel. Aty nuk të sheh askush dhe nuk e mëson asgjë nga të njohurit", ishte sugjerimi i parë.

**Tortura me korent në vaskë**

Por vajza nuk pranon. Madje i lutet që ta fusë në punë të rëndë, që të sigurojë ajo të ardhurat. Dhe përsëri Jerosimi nga fshati vazhdon në të tijën. Hapi i dytë i tij është futja e shokëve dhe kushërinjve të kërcënonin vajzën, kur ai nuk ishte në shtëpi. Por përsëri vajza vazhdon në të sajën. Atëherë diplomati radhë. "Tortura të stilit japonëz", do të pohonte ajo gjatë denoncimit të saj në polici. Dikur e ka zhveshur dhe e futur në vaskë dhe pasi ka marrë një fazë korenti e ka futur fillin në ujë. "U detyrova të prostituoja", thuhet në dëshminë e vajzës. Dhe ka matur trotuaret e Milanos për katër vjet rresht. Dhe ishte aq e bindur, sa Jerorosimi kthehet dhe jeton me gruan e vet në Lushnjë, ndërsa vajza punonte për të, pa e kthyer kokën pas.

**Arrestimi i tutorit**

Para katër ditësh të njëjtën vajzë, policia italiane e kthen në Rinas. Aty Policisë, vajza është bllokuar dhe atë kanë ardhur e kanë marrë "specialistët" e Kolonel Xhavit Shalës, Drejtorit të Policise së Fierit, një skuadër e shquar në përpunimin e prostitutave të kthyera dhe në arrestimin e tutorëve. Menjëherë pas denoncimit të vajzës, një skuadër policie është nisur për në fshatin Kolonjë të Lushnjës dhe ka bërë arrestimin e tutorit Jerosimo Koja. Ndërsa është lajmëruar edhe e ëma për vajzën. Gruas së shkretë, që prej 5 vjetësh e quante të vdekur i ka rënë të fikët nga gëzimi. Një tjetër çast gëzimi ka qenë edhe takimi me të bijën të strehuar në Qendrën e Reha-

GJYKATA E APELIT

## "Vëllezërit kodoshë:" Kërkojmë pafajësi

Dy vëllezërit Pjetër dhe Agim Pepa (Shurbi), të cilët më 26.12.2001 janë dënuar nga Gjykata e faktit të Mirditës përkatësisht me 6 dhe 2 vjet burg nën akuzën për shfrytëzim prostitucioni, kanë kërkuar dje në Gjykatën e Apelit pafajësi. Avokati i tyre mbrojtës Qazim Gjoni është shprehur në Apel, se vendimi i Gjykatës së Mirditës është i pabazuar në fakte dhe prova. Vajza për të cilën akuzohen dy vëllezërit Pepa, se e kanë shfrytëzuar për prostitucion, ka qënë e fejuara e Pjetrit. Sipas avokatit dy të rinjtë pasi u fejuan me pëlqimin edhe të familjeve, shkuan në Itali për të siguruar një jetë më të mirë. Por gjatë një kontrolli, që ushtroi policia italiane në banesën ku qëndronte çifti, u ndalua e fejuara e Pjetrit, Emanuela, e cila kishte hyrë në shtetin fqinjë pa vizë dhe riatdhesohet nga organet italiane. Disa kohë pasi ishte kthyer në Shqipëri, Emanuela denoncon të fejuarin e saj Pjetrin dhe vëllain e tij Agimin se e kanë çuar në Itali për të ushtruar prostitucion. Këtë akuzë avokati mbrojtës e ka kundërshtuar me faktin se nuk ka të dhëna, që Emanuela të ketë kërkuar ndihmë nga policia italiane, apo të ketë bërë një denoncim të tillë në Aeroportin e Rinasit në momentin e mbërritjes. Sipas avokatit ajo është shtyrë nga të afërmit e saj për të bërë këtë denoncim dhe nuk ka asgjë të vërtetë në këtë histori. Trupi gjykues i Apelit pasi dëgjoi argumentat e avokatit ka përcaktuar datën 20 shkurt për dhënien e vendimit përfundimtar.

G. Janku

Korrieri 16.2.2002

KORRIERI 15.12.2001 AKTUALITET

# Historia e njërës nga ato

Si përfundoi në trotuaret e Italisë, prej të fejuarit të vet. Tentativa për t'u vetëvrarë duke prerë damarët dhe tortura prej 7 muajsh. Si arriti, të kthehej në Shqipëri e të denonconte fajtorin. Rrëfimi i 19-vjeçares nga një fshat i Fierit e strehuar në qendrën e pritjes dhe mbrojtjes së viktimave të trafikut

Alma MILE



*Në Qendrën e Pritjes dhe Mbrojtjes së viktimave të trafikut*

Me duar të ftohuara, ajo kishte dalë në rrugë. Plagët ende të pampiksura i dhimbnin, por më tepër i dhimbte shpirti. Tmerri dhe të ftohtët e asaj nate, e kishin mpirë të tërën. Duhej të ecte, ndoshta kështu do të ngrohej disi. Hodhi hapat e parë të trumbur. Kishte turp, buzët i dridheshin. Ajo punë nuk ishte për atë. Filloi të ecte në ato pak metra rrugë, që do të ishte territori i saj i "punës". Për shtatë muaj rresht Anxhela, e kishte përsëritur të njëjtin ritual. Çdo buzëmbrëmje do t'a gjente atë aty, duke numëruar për të miliontën herë pllakat e asaj copëze trotuari, të një prej qyteteve të fqinjit të përtej Adriatikut. Sa herë që ndaj të gdhirë kthehej në shtëpi, i dorëzonte atij 1-1,5 milionë lireta. Ishin paratë e trupit të saj. Ishte 19-vjeç. Shoqet e saj, atje në Levan të Fierit, tashmë ishin duke menduar për nusërinë, disa kishin shkuar edhe në universitet, kurse ajo... I vinte turp kur shkonte nëpër mend punën që bënte. Shpesh kundërshtonte, por

e thikës."

Ishte 17 vjeç atëherë, kur pas largimit të nënës së saj nga shtëpia, së bashku me të

motrash të tjera për të rregulluar, [illegible] kishte. "Nuk kishim shumë kohë të fejuar, kur të dy shkuam në Greqi,

josheshin prej flokëve të saj të gjatë, syve të saj të zinj, trupit të derdhur dhe nuk do të ishte shumë e vështirë

parandjerë. Ai më urdhëroi t[illegible]ishja ca rroba të turpshme e të dilja në trotuaret e Milanos. Nuk pranova,

në Shqipëri, tek njerëzit e saj. "Tani kam vendosur që t'a padisë, tha ajo, ai më shkatërroi jetën, më mashtroi, kështu që për mua nuk ka rrugë tjetër." Ndërsa prokurorët e çështjes, janë duke përgatitur dosjen e të akuzuarit, ajo është nën mbrojtjen e policisë së rrethit të Fierit, në qendrën e re të pritjes, të hapur vetëm pak ditë më parë. Por ajo nuk është vetëm, bashkë me të janë edhe 5 vajza të tjera, disa kanë edhe fëmijë, të cilët kanë vite pa i parë. Të gjitha viktima të trafikut të qenieve njerëzore. Por që kanë arritur të dalin mbi veten e tyre, mbi frikën dhe kërcënimet që nuk u ndahen. Ato kanë mundur të denoncojnë fajtorët, gjë të cilën jo shumë kanë patur guximin t'a bëjnë. Ato nuk e dinë se çfarë i pret jashtë dyerve të qendrës së pritjes. Ende nuk e dinë se ç'ti kërkojnë jetës. Ajo ka qenë e ashpër me to, ndaj edhe nuk i besojnë shumë. Fati i përplasi ashtu si nuk e kishin menduar, ndaj kanë frikë të kërkojnë e të thurin plane e ëndërra. E trembur, Anxhe-

KORRIERI 15.12.2001

# Zbulohet shtëpia e prostitutave

***Policia e Fierit shpartallon një bazë të ushtrimit të prostitucionit. Në pranga dy motrat-skllave dhe katër tutorët.***



**Lavdosh Caushi, datëlindja 17.01.1966, Roskovec**
**Akuza: Shfrytëzim prostitucioni**



**Kastriot Koka**
**datëlindja 08.01.1966 Tepelenë**
**Akuza: Shfrytëzim Prostitucioni**



**Filip Raco, datëlindja 05.09.1966**
**Akuza: Shfrytëzim prostitucioni**

**FIER** - Zbulohet një shtëpi publike në qytetin e Fierit. Të gjashtë "banorët" e saj përfundojnë në pranga. Dy prostitutat, Merita Kaçaniku e Bedrie Kaçaniku, së bashku me 4 tutorët e tyre, Filip Raco, Aida Raco, Kastriot Koka dhe Lavdosh Caushi, u arrestuan në flagrancë për ushtrim dhe favorizim prostitucioni. Grupi u zbulua dje pasdite, gjatë një patrullimi të inspektorëve të postës së policisë së Roskovecit, në thellësi të asaj zone, midis fshatrave Jagodinë dhe Suk 1. Kur vuri re tu afrohej një veturë e panjohur luksoze "Mercedes Benz 5000" me targa franceze, komandanti i postës së policisë Agron Kanani, urdhëroi ndalimin dhe kontrollin e makinës së dyshimtë. Gjatë verifikimit, asnjë prej udhëtarëve nuk kishte dokumenta identifikimi, prandaj u shoqëruan në polici menjëherë. Ata ishin katër. Personat e dyshimtë pranuan se merreshin me trafik femrash. Në hetimet e para, ata treguan edhe emrat e bashkëpunëtorëve të tyre, që janë dy bashkëshortë nga Fieri dhe që u arrestuan më pas nga policia. Njëri prej të ndaluarve, Kastriot Koka, 35 vjeç, nga Tepelena, ishte kthyer nga Belgjika, ku kishte përgatitur "terrenin" për prostitutat që do të mbërrinin atje. Vajzat-skllave janë motra njëra me tjetrën. Merita, 25 vjeç, beqare, nga fshati Hoxharë e Fierit, kishte prostituar në rrugët e Italisë në vitet 1994-1995, deri kur policia italiane e kishte ndaluar për ta riatdhesuar. Kohët e fundit, Merita kishte bindur motrën e saj 18-vjeçare Bedrien, për të ushtruar edhe ajo të njëjtin zanat. Nga hetimet paraprake, doli që motrat ishin rekrutuar nga një çifti i bashkëshortëve Raco. Bashkëshortët e kishin shndërruar në shtëpi publike apartamentin e tyre, në lagjen "11 janari" të qytetit të Fierit. Të paktën për dhjetë ditë radhazi, shtëpia u përdor për prostitucionkurvëri. Atje shkonin klientë të çfarëdoshëm kundrejt çmimeve jo standarde, që fillonin nga 5 mijë lekë të vjetra. Kur u pyetën nga oficerët e policisë gjyqësore, të ndaluarit e pranuan se kishin kryer veprimtarinë e paligjshme. Ata thanë gjithashtu se po përgatiteshin për ti transportuar të dyja motrat për prostitucion në Francë e Belgjikë, çka ishte qëllimi kryesor i tutorëve. Këtë vit, policia e Fierit ka goditur 5 grupe të trafikut të qenieve njerëzore, gjatë përpjekjeve të tyre për të transportuar jashtë shtetit 22 vajza shqiptare dhe të huaja.

**G.Ruko**

***Njëri prej të ndaluarve, Kastriot Koka, 35 vjeç, nga Tepelena, ishte kthyer nga Belgjika, ku kishte përgatitur "terrenin" për prostitutat që do të mbërrinin atje.***



**Aida Raco, datëlindja 02.09.1971**
**Akuza: Shfrytëzim prostitucioni**



**Merita Kaçaniku, datëlindja 21.03.1976, Hoxharë**
**Akuza: ushtrim prostitucioni**



**Bedrie Kaçaniku, datëlindja 26.08.1983, Hoxharë**
**Akuza: ushtrim prostitucioni**

Koha jone 9.09.2001

# Kronika

**TABELE E TRAFIKUT TE PROSTITUCIONIT NE QARKUN FIER**

| Vitet | Femra shqiptare | Femra të huaja | Denoncime | Autorë | Grupe |
|---|---|---|---|---|---|
| 1992-1997 | 64 | - | 36 | 45 | 7 |
| 1998 | 21 | - | 5 | 17 | 1 |
| 1999 | 19 | 27 | 31 | 29 | 5 |
| 2000 | 31 | 25 | 27 | 40 | 6 |
| 2001 | 17 | 5 | 12 | 26 | |

**5*BURIM: Drejtoria e Policisë Fier**

# Fieri, jo më qendër e prostitucionit







*Drejtori i Policisë, Xhavit Shala, harton strategjinë për të hequr një herë e përgjithmonë plagën dhjetëvjeçare. Një aksion, në të cilin do të marrë pjesë e gjithë shoqëria, media, feja por edhe OJQ-të.*

Gentian Ruko

**FIER** - Nis në muajin tetor operacioni anti-prostitucion. Do të fillojë në Fier për t'u shtrirë hap pas hapi në të gjitha vatrat e trafikut në vend. Plani është që strukturat e pushtetit lokal të "shkrihen" me policinë. Policia dhe pushteti lokal do të mbështeten nga gjithë shoqëria, që do të ngrihet në këmbë, duke synuar të godasin trafikun e qenieve njerëzore si kurrë më parë. Hollësitë e një stategjie të re kundër trafikut të prostitucionit, Xhavit Shala i publikoi dje. Ai shtoi se studimi është mirëpritur në Ministrinë e Rendit Publik.

Pasi zbatoi, për herë të parë, një plan strategjik antidrogë, i cili e zhduku Fierin nga harta e kultivimit masiv të hashashit, drejtori i policisë së Fierit rishfaqet kështu nismëtar i një lufte tjetër shkencore kundër krimit të organizuar, që mendohet të jetë edhe më i ashpër. Shala tha se do të jetë sërish pushteti lokal krahu i djathtë i uniformave blu. "Besoj që hashkiakët dhe komunarët do të bëhen bashkëpunëtorët më të ngushtë të uniformave blu", theksoi drejtori i policisë së Fierit. Komunarët do të përfshihen në planet e masave të policisë për t'i siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm: cilat janë vajzat e marra për prostitucion, kush i ka mashtruar, kush i shfytëzon, ku ndodhen, çfarë pretendimesh kanë prindërit e viktimave dhe çdo të dhënë tjetër që do të kërkojë policia. Shala i konsideroi po aq të rëndësishme marrëdhëniet me prokurorinë. Ai kërkoi që të ndyshojë praktika e deritanishme e prokurorisë, e cila ka refuzuar në 8 raste, të fillojë ndjekjen penale kundër autorëve të mundshëm të krimit, sepse prokuroria ka pretenduar që kallëzimin kundër tyre duhej ta bënin medoemos vetë vajzat e dëmtuara. Shala tha se këtej e tutje, prokuroria duhet të pranojë denoncime edhe nga prindërit e vajzave. Madje, çështja penale duhet të fillojë qoftë edhe vetëm me kallëzimet e policisë. Kjo mendohet t'i hapë rrugën denoncimeve që mund të vijnë nga Interpoli dhe misioni Interforce, pasi policia ndërkombëtare të ketë dokumentuar veprimtarinë kriminale të fierakëve në shtetet e ndryshme të botës. Plani i Shalës përfshin edhe organizatat joqeveritare, që do të mobilizohen në një fushatë këshillimi, ndërsa mediat lokale do të fillojnë transmetimin e cikleve të gjatë të emisioneve edukative. Do të thirren në aksion edhe klerikët, që bashkë me të zgjedhurit vendorë, do të trokasin shtëpi më shtëpi, për t'i dhënë zemër familjarëve të denoncojnë tutorët e vajzave të tyre. Xhavit Shala theksoi se operacioni do të bëhet patjetër, duke u përshkallëzuar, për t'u përmbushur detyrimet që qeveria ka përpara shoqërisë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Ai e vlerësoi alarmante situatën në territorin e qarkut të Fierit, i përdorur si stacion i trafikut ndërkombëtar të qenieve të gjalla. Në dhjetë vitet e fundit, policia rajonale ka regjistruar se janë trafikuar 152 femra shqiptare, 56 të huaja, kryesisht rumune dhe moldave, 111 denoncime për favorizim prostitucioni kanë mbërritur në komisariatet e policisë së Fierit, 15[illegible] persona janë konstatuar të implikuar, 24 grupe kriminale janë zbuluar e goditur dhe 6 skafe janë sekuestruar. Drejtori i polocisë së Fierit pohoi se tutorët i kanë sofistikuar sjelljet e tyre, por paralelisht policia vazhdon të rrisë forcën goditëse.

Drejtori i Policisë Xhavit Shala tregon strategjinë e luftës antiprostitucion

# Fier, për një muaj 30 tutorë në qeli

FIER - Nis të zbatohet në Fier strategjia Shala kundër prostitucionit. Drejtori i policisë së Fierit, Xhavit Shala, nuk e fshehu kënaqësinë dje para gazetarëve, ndërsa pohoi se vetëm muajin e fundit ka bërë të arrestohen 30 tutorë. Strategjia e tij konsiston në bashkëpunimin e ngushtë të policisë me komunat dhe familjet e viktimave të trafikut. Dialogu mes tyre nuk duhet të njohë rezerva, është rregulli nr.1 i marrëveshjes. Për herë të parë, policia dhe organet e drejtësisë vihen re të jenë radhitur në të njëjtin front kundër trafikut të prostitucionit. Kështu, në 12 raste, për të 18 të arrestuarit nga policia, gjykata ka vendosur masën e sigurimit të arrestit në burg. Ndërkohë që 12 tutorët e tjerë, që nuk janë Shqipëri, janë shpallur persona në kërkim. Shala thotë se rrjetet e goditura të trafikut kanë një gjeografi nga jugu deri në veri të vendit. 57 për qind e trafikantëve të arrestuar janë nga rrethe të ndryshme të Shqipërisë.







Faksimile e të dhenave të prostitucionit dhe luftës së tij në Qarkun e Fierit

## KRONOLOGJIA

Të parët që patën "fatin të provonin" planin strategjik të Shalës, ishte një grup i kapur në zonën e Roskovecit. Më 8 shtator, ata udhëtonin me një veturë "Mercedes Benz 5000" me targa franceze, në një rrugë pranë fshatit Jagodinë, kur ranë në sy dhe u ndaluan nga forcat e postës së policisë së Roskovecit. 35-vjeçari Kastriot Koka nga Tepelena sapo ishte kthy-

tohej me një të huaj në Francë. Por, derisa sa të vinte koha për të kaluar detin Adriatik, të dyja motrat ushtronin prostitucionin, kundrejt çfarëdo çmimi dhe klientësh, në apartamentin e shndërruar në shtëpi publike të familjes Raco. Më 10 shtator, u ndalua 34-vjeçari Vullnet Krasniqi nga fshati Barbullinië

femër e dyshimtë. Agjentët e antikrimit u hodhën në veprim dhe gjetën në vilë 17-vjeçaren M.D. Ajo pohoi se Gentjan Muharremi nga Libofsha e kishte rrëmbyer pranë shtëpisë së saj në lagjen "Çole" të Vlorës. Muharremi është shpallur peson në kërkim. Më 24 shtator, një postbllok policor i

rati, u ndaluan për rrëmbim dhe përdhunim të një 19-vjeçareje nga lagja "Liri Gero" e Fierit. Siç shpjegoi në polici e dëmtuara, vajza kishte marrë më parë një propozim për martesë nga Murati. Një ditë, në mirëbesim, ajo e pranoi në shtëpi ndërsa prindërit e saj nuk ndodheshin. Por, Murati e kërcënoi me pistoletë dhe e dërgoi në Vlorë për ta nisur më pas me skaf për Itali. Murati dhe polici Zëraj e përdhunuan ... ly për ta nënshtruar vajzën. Por, në çastin e fundit, prindërit e 19-vjeçares A.G. denoncuan në polici dhe arritën ta marrin vajzën e tyre. Më 8 tetor, ishte "radha" e prangosjes së një grupi nga Elbasani. Në orën 15, Armando Mitarja, 39 vjeç, kishte zbritur nga trageti italian në Durrës dhe takuar aty bashkëqytetasin e tij 20-vjeçar Enver Vllahja. Vllahja dhe Zaide Licaj, një grua e martuar, nënë e dy fëmijëve, ia dorëzuan të sapoardhurit shtetasen R.O. kundrejt 300 mijë lekëve. Pa humbur kohë, Mitarja dhe R.O. u nisën me taksi drejt Vlorës, por nuk mundën ta kalonin Fierin. Ata përfunduan në qeli bashkë me "shitësit" Vllahja dhe Licaj. Më 14 tetor, forcat e policisë së Ballshit arrestuan plakun trafikant Qamil Levanaj. Djali i tij 23-vjeçar, Alfredi, kishte njohur në Greqi një grua nga Bulqiza që bashkëshorti e kishte detyruar të prostituonte në një klub nate në ishullin e Kretës, që nga dita e dytë e martesës. Kur në nëntor të vitit 1999, gruaja Sh.K. u njoh me ballshiotin, ajo mendoi të fillonte

mashtrimit dhe policia shqiptare lajmëroi familjen e saj në Bulqizë. Por i pari në Rinas mbërriti vjehrri trafikant i cili e mori sërish në shtëpinë e tij. Denoncimi i familjarëve bëri që policia e Ballshit të ndërhyjë në kohë dhe gruaja iu kthye prindërve, plaku përfundoi në qeli, ndërsa djalin e tij e "presin" prangat nëse guxon të kthehet në Ballsh. Më 16 tetor, në Lushnjë, u arrestuan tutorët Arben Çibuku dhe Hernan Satka. Satka dhe një bashkëpunëtor i tij, Artur Prifti, shkuan në Maqedoni dhe ranë dakort me pronarin e një hoteli në Strugë për të blerë dy moldave të strehuara në atë hotel. Mirëpo, gjatë natës, ata dhe moldavet ikën fshehtazi nga hoteli. Satka dhe vajzat fundore e kaluan kufirin nëpër male, ndërkohë që Prifti e kaloi në makinë pikën kufitare. Ata u bashkuan në tokën shqiptare dhe pas shtatë orësh udhëtimi arritën në shtëpinë e Satkës, në Divjakë të Lushnjës. Ndërsa Prifti u nis për Itali për të pritur moldavet. Satka gjeti një ofertë të leverdisshme, kur shtetasi Arben Çibuku i dha në dorë 3 milionë lireta për të blerë njërën nga moldavet, të cilën e strehoi në një apartament që kishte marrë me qera në lagjen "Kongresi i Lushnjës". Një telefonatë anonime bëri që policia të zbulonte rrjetin. Çibuku u arrestua në flagrancë së bashku me moldaven dhe ai nxorri edhe emrin e Satkës i cili u ndalua më pas në Divjakë me moldaven tjetër. Më 18 tetor, policia italiane ...

KOHA JONE 28.10.2001

# Kronika

**Trafiku**

Vetëm në tre muaj janë konstatuar 26 raste dhe implikuar 34 autorë. Nga këto, 24 të trafikut të femrave, një i fëmijëve dhe një i klandestinëve

## Fier, atje ku nis goditja e rrjeteve kriminale

Artur Qorraj

Ngritja e Qendrës së Pritjes së Viktimave të Trafikut në Fier ka çuar në evidentimin e të gjitha viktimave të prostitucionit dhe të këtij trafiku që prej vitit 1991. Studimi i ndërmarrë nga kjo polici, e drejtuar nga kolonel Xhavit Shala, është mbështetur në strategjinë kombëtare të luftës ndaj trafiqeve. Janë krijuar grupe inspektoresh që mbledhin dëshmitë, evidentojnë viktimat, intervistojnë dhe i mbrojnë ato. Në studimin e kryer menjëherë pas ngritjes së qendrës në vitin 2001, gjatë kësaj kohe janë evidentuar dhe proceduar 54 raste me 61 viktima të trafikut. Janë proceduar 107 autorë, nga të cilët arrestuar 51 dhe ndiqen në gjendje të lirë në pritje të masës nga gjykata 56 të tjerë. Shumica e viktimave të trafikut, sipas shifrave janë me arsim të nivelit të ulët, 58 % banojnë në fshat, 68 % janë të moshës 13-20 vjeç dhe rreth 80% e tyre janë beqare. Sipas kolonel Xhavit Shalës, brenda tre muajve të parë të këtij viti, nga policia Fierit janë konstatuar 26 raste të trafikut të qenieve njerëzore. Nga këto, 24 të trafiku të femrave, 1 fëmijëve dhe 1 i trafikut klandestin, ndërsa të implikuar janë 34 autorë, për 25 viktima të trafikuara. Gjithsej brenda dhjetëvjeçarit janë penalizuar 271 autorë të trafikut.


Qendra e Pritjes së Viktimave të Trafikut Fier

*Studimi i hartuar dhe funksionimi i qendrës është vlerësuar si një praktikë e mirë për mbrojtjen e dëshmitarëve*

### Vizitat në Qendrën e Pritjes së Viktimave të Trafikut në Fier

Menjëherë pas ngritjes dhe funksionimit të kësaj qendre, ku priteshin kryesisht viktimat e seksit femër, të shfrytëzuara nga trafikantët në shtetet perëndimore, nuk kanë munguar vizitat e shumta të autoriteteve shtetërore shqiptare e të huaja. Këtë qendër e kanë vizituar Ambasadori i OSBE-së, Gert Ahrens, në ditën e përurimit, përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar për Rendin dhe ShIK-un, reporterët e Këshillit të Europës, drejtuesit e misionit amerikan, ICITAP, përfaqësues të organizatave të shumta shqiptare e të huaja që merren me trajtimin e viktimave dhe me të drejtat e njeriut, përfaqësues të mediave vendase e të huaja. Por ngritja kësaj qendre pritjeje është vlerësuar edhe nga autoritete të tjera të larta, si Departamenti Amerikan i Shtetit, në raportin për të drejtat e njeriut në Shqipëri për vitin 2001 dhe Zëvendësshefi i Antimafias Italiane, Francesko Mandoi, më 25 mars të këtij viti, duke e konsideruar praktikën të njëjtë me atë që ndiqej në Itali për mbrojtjen e dëshmitarit.

### Mbrojtja e dëshmitarëve

Është një nga praktikat më të domosdoshme që mbrohet fort në Qendrën e Pritjes së Viktimave të Trafikut në Fier. Vetë Kolonel Xhavit Shala shprehet se gjatë një viti është zbatuar kjo praktikë, ku viktimat, sidomos femrat që shfrytëzoheshin për prostitucion nga autorët, trajtoheshin në qendër me metodat bashkëkohore të mbrojtjes në cilësinë e një dëshmitari. Rrëfimi i këtyre viktimave ishte mjaft me interes, pasi jepnin dëshmi të sakta dhe ndihmonin drejtësinë shqiptare, por dhe ato të vendeve ku ishin shfrytëzuar, për të goditur rrjetin e trafikantëve klandestinë, të prostitucionit, drogës, etj. Këtë fakt e ka vënë në dukje edhe vetë Zv-shefi i Antimafias Italiane, Francesko Mandoi, gjatë një seminari në muajin mars të këtij viti. Ai theksoi se qendra e Fierit është një dëshmi e asaj që dhe në Itali, marrja në mbrojtje e dëshmitarëve, deri në sigurimin e plotë të tyre. "Vajzat e shfrytëzuara qëndrojnë në atë qendër, derisa sigurohet dëshmia ndaj autorëve dhe merren në mbrojtje nga autoritetet shtetërore", është shprehur Mandoi gjatë seminarit, duke dhënë një shëmbull të qartë.

# "Mirësevini të dashura prostituta"

**Shpresojnë të gjejnë një shtet që t'i mirëpresë, por gjejnë një sistem ligjor që i ndëshkon ndonëse janë viktima. Por jo vetëm kaq. Edhe polici shpesh herë brutale, familje armiqësore dhe një shoqëri hermetike. Viktimat e prostitucionit në udhëkryq**





Bruna sot gjendet në një vend sekret. Ishte 16 vjeçe, kur gux oi të denoncorte tutorin e saj. Në kokë i duket akoma vraga e një të çare, kujtim nga ditët e "lumtura" në Itali. Në gjoks, gjithashtu. E kishin rrëmbyer që 14 vjeçe.

"Tutorët e saj ishin tre dhe nëpërmjet tyre zbuluam edhe 15 të tjerë. Ishin më të fortët në Tiranë dhe mjaft të rrezikshëm", thotë drejtuesja e qendrës "Vatra", që merret me rehabilitimin e viktimave të prostitucionit në Vlorë.

"Kur erdhi tek ne, Bruna mezi mbahej në këmbë. E kishin dhunuar keqaz, duke e lënë me pasoja. Mbante paruke, pasi koka i ish dëmtuar rëndë nga rrahjet e shpeshta të tutorëve të saj. Në gjoks kish një të çarë dhe mjekët që e vizituan panë se, madje edhe timpanët e veshëve të saj ishin shkatërruar", vazhdon drejtoresha.

Të 18 tutorët u kapën, por pas 8 muajsh në qelitë e paraburgimit, u ishin harruar edhe emrat. "Me siguri duhet të jenë kthyer në Itali", thotë drejtoresha. Ajo nuk dëshiron të saktësojë asgjë, por garanton se vajza është sistemuar në një kolegj në Itali. "Normale. Tutorët nuk e braktisin kurrë aq lehtë prenë e tyre", ngre supet e






maj.ta qendra e rehabilitimit të viktimave të prostitucionit e ngritur kohët e fundit nga policia e Fierit. Lart Elsa Ballauri, kryetarja e grupitshqiptar të të drejtave të Njeriut, njëra nga partizanet më të zjarrta të legalizimit të prostitucionit
Poshtë në faqen e parë, Xhavit Shala, drejtori i policisë së prefekturës Fier,

pafuqishme ajo. Por Bruna nuk është e vetmja:

Viktimat e prostitucionit që kaptojnë një det me rreziqe për të trokitur në derën e drejtësisë shqiptare, nuk e dine çfarë i pret matanë saj. Ato shpresojnë të gjejnë njerëz që t'i kuptojnë, por bien pre e paragrafëve me shumë kuptime të legjislacionit shqiptar. Ato ëndërrojnë të gjejnë ligjin e barabartë për të

gjithë, por mësojnë ligjin e atij që paguan më shumë. Ndërsa pritet që nga sallat e gjykatave të Shqipërisë të lindin shpresat e këtyre njerëzve të dëshpëruar për një jetë të re, këto shpresa shuhen nga dënime të ashpra gjyqësore, që dënojnë çdo femër që ushtron prostitucionin, deri në tre vjet burg.

Ndërkohë, lehtësia e manipulimit të gjyqtarëve (dhe shpesh inkompetenca e tyre), kanë lënë në liri secilin trafikant që dërgon një zarf banknotash në adresën e duhur. Një raport i Human's Rights Eatch, për vitin që sapo shkoi, thotë se në

Shqipëri jo vetëm që lulëzon një treg i begatë skllavesh të seksit, por edhe në rastet kur shteti vendos përpara bankës së drejtësisë si të akuzuar vajzat e trembyera me tutorët e tyre, ato që e pësojnë janë pikërisht të parat. Ndërsa trafikantëve, vetëm sa u tërhiqet pak veshi dhe u thuhet: mos e përsërisni më.

Më pas ata lihen menjëherë të lirë.

Luan Omari, një profesor i njohur shqiptar i së Drejtës, thotë se ky është një paradoks i madh. "Kjo ka lidhje me vështirësitë që po has, prej 10 vjetësh tranzicion, sistemi shqiptar i drejtësisë në rrugën e tij drejt pavarësisë", këmbëngul profesori në zyrën e tij të Akademisë së Shkencave. "Pavarësia e

gjyqësorit nuk është vetëm ajo nga politika, por edhe nga ndikimet e mafias, ku përfshihen edhe rrjetet e ndryshme të trafikut", shton ai. Profesor Omari kujton sesi para viteve '90, kur në Shqipëri nuk njihej koncepti i trafikantëve të seksit, në kodin penal të Republikës dënohej, dhe ashpër madje, vetëm ushtrimi i prostitucionit. "Mund të themi se situata është pak a shumë e njëjta, ndonëse për arsye të tjera", thotë profesori. Profesor Omari ishte dakord me mendimin se tani, jo vetëm që prostitucioni e ka kaluar këtë fazë "primitive", por se tani nuk mund të bëhet më fjalë për trafik në nivele spontane. Ai tha me bindje se trafikantët e seksit janë tashmë të mirëorganizuar dhe kanë krijuar rrjete të mirëfillta mafioze, të afta të korruptojnë shumë prej prokurorëve dhe gjyqtarëve shqiptarë, lehtësisht të tundueshëm për shkak të pagave të ulëta shtetërore. Por, sipas profesor Omarit, problemi më i madh janë lidhjet që kanë krijuar këto rrjete të organizuara trafikantësh me nivelet e larta të pushtetit. "Trafikant tashmë mund të jetë kushdo, një zyrtar i korruptuar, një baba i mir, një ministër. Natyrisht, për gjykatësit që vijnë nga një traditë e gjatë komuniste, është shumë e kollajshme t'i bien shkurt dhe që, në vend të tyre, të dërgojnë në qeli prostitutat", thotë profesor Omari.

Por kjo dëshirë e gjykatësve (për të mos i hapur telashe vetes duke fituar njëkohësisht paraì), ka dërguar drejt greminës me dhjetëra vajza të reja, viktima të prostitucionit. Sipas disa shifrave të përafërta të Organizatës "Save the children" në Itali, janë mbi 30 mijë vajza shqiptare, që janë bërë pre e këtij trafiku ndërkombëtar. Nga këto, rreth 15 mijë në Itali dhe 6 mijë të tjera në Greqi. Në shumë nga qendrat e ngritura në Shqipëri për prostitutat e krijuara nga OJQ-të ndërkombëtare, si dhe në ndonjë të ngritur nga policia, mund të konstatohet lehtë se mosha mesatare e këtyre vajzave vërtitet nga 13-25 vjeç ose edhe më shumë: ndjenjat e trafikantëve nuk preken nga moshat e njoma. Vitin e kaluar autoritetet italiane thanë se 168 prostituta të huaja u vranë në vend nga protektorët e tyre, shumica e të cilave: shqiptare dhe nigeriane. Për vit policia shqiptare, merr në dorëzim disa qindra prej këtyre vajzave, të kapura në trotuaret e Italisë nga ana e policisë italiane. Në shumë raste, italianët dërgojnë në Shqipëri edhe tutorët e tyre. "Peshq" të tillë bien me bollëk edhe në rrjetat e policisë shqiptare gjatë inkursioneve të saj të befishme nëpër disa nga qytetet më të dalluara të jugut për këtë lloj trafiku. Sipas shifrave zyrtare nga drejtoria e luftës

kundër trafiqeve në Ministrinë e Rendit Publik, vetëm gjatë vitit 2001 policia shqiptare arriti të bllokoje 113 raste të trafikut të femrave për prostitucion, duke sekuestruar njëkohësisht 58 gomone dhe 11 mjete të tjera, që përdoreshin për këtë trafik. Mirëpo, siç tha me dëshpërim një nga prokurorët e antitrafikut në Prokurorinë e Tiranës, i gjithë rezultati i punës së tij dhe kolegëve të tij, përfshihej në 6 prostituta moldave, të cilat janë duke vuajtur në burgun 313 të Tiranës dënimin për ushtrim prostitucioni. "Ato janë të gjitha vajza të kapura në hotelet shqiptare që nga Shkodra e deri në Tiranë, por askush nga tutorët e tyre nuk ka provuar akoma prangat, madje asgjë s'u ka ndodhur as pronarëve të hoteleve dhe askujt tjetër", tha ai, duke shtuar se refuzon të identifikohet me emër për shkak të rreziqeve që do t'i duhej të përballonte. Po sipas tij, nëse burgjet e Shqipërisë janë të mbushura me vajza shqiptare, moldave ose ukrainase të kapura, ndërsa fitonin bukën duke dhuruar trupin, nga gjykatat nuk janë dënuar më shumë se 10 ose 20 trafikantë, që përfitojnë dhe i nxisin këto vajza të prostituojnë, duke i dhunuar madje ato në shumë raste. Drejtori i policisë së Fierit, foli me dëshpërim për tentativat e tij të kota për të shpëtuar sa më shumë prej këtyre viktimave. Zoti Shala tregoi sesi ai kishte ndërmarrë një fushatë për sqarimin e banorëve të zonës së tij, për të keqiat e trafikimit. Rezultatet ishin të menjëhershme.

Akuzat ndaj tutorëve dhe trafikantëve u rritën me 400 përqind vitin që shkoi, thotë kolonel Shala. Por akuzat nuk mbylleshin me dënimin, sepse për shkak të boshllëqeve të sistemit ligjor, policia ishte e detyruar të lironte pas 10 orësh të gjitha viktimat e prostitucionit që kapte, ose t'i akuzonte ato për ushtrim prostitucioni. Ato vajza nxirreshin kështu në rrugë, duke u bërë një gjah i lehtë për tutorët e tyre që i dërgonin menjëherë për në Itali.

Edhe Elsa Ballauri, kryetare Grupit shqiptar për të Drejtat e Njeriut, thotë se nëse shkaqet e përhapjes dhe zhvillimit të këtij rrjeti të mirë organizuar janë kryesisht ekonomike e sociale, një dorë të mirë ndihme i jep këtij lulëzimi edhe legjislacioni defektoz shqiptar. "Sistemi ynë politik dhe gjyqësor është i korruptuar. Trafikantët kanë mundësi për të paguar. Ato që e pësojnë janë të kthyerat dhe kjo, pasi mungojnë strukturat për rehabilitimin e tyre", thotë Ballauri.

Më 1995, për herë të parë, u hartua një ligj i cili e konsideronte si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim ushtrimi prostitucioni. Por as ky formulim nuk i zgjidhi problemet. Në shkurt të vitit 2001, ligji mbi trafikun e prostitucionit u përmirësua. Ligji në fuqi thotë se trafiku i femrave për prostitucion meriton burgim nga 7 deri në 15 vjet. Ndërkur ka sjellë si pasojë vdekjen e viktimës, trafikanti dënohet deri me burgim të përjetshëm. Këto dispozita shoqërohen me konfiskimin e mjeteve dhe të gjitha përfitimeve të tjera materiale. Në bazë të Ligjit, edhe mbajtja e lokaleve apo çfarëdo ambjenteve të tjera për shfrytëzim prostitu-

# Legalizim po! Legalizim jo!

Më në fund në Shqipëri zërat që kërkojnë me zgjidhje të të gjitha problemeve që lidhen me ushtrimin e prostitucionit, kanë nisur të kërkojnë më me guxim pikërisht legalizimin e tij. Gjë që, si hap të parë dhe më emergjent, do të kërkonte abrogimin e ligjit të vjetër të trashëguar nga legjislacioni komunist. Ky ligj dënikos si fajtore çdo vajzë, e cila vendos të ofrojë në këmbim të shpërblimit, trupin, ndryshe nga pjesëtarë të tjerë të shoqërisë që ofrojnë shërbime prej këshillash, të mirash materiale, ose produktesh intelektuale. Diana Çuli, një shkrimtare e njohur shqiptare dhe njëkohësisht një nga veprimtaret më të shquara të të drejtave të grave, thotë se ky ligj është tërësisht jashtë kohe dhe është burimi i një pjese të madhe të problemeve, me të cilat përballen sot viktimat e prostitucionit. Ndonëse mendon se shifrat që qarkullojnë prej disa vitesh në Edhie me numrin e prostitutave shqiptare në Evropë janë tejet të fryra, zonja Çuli, e cila është edhe presidente e një OJQ-je të madhe që asiston gratë me telashe, thotë se në vend që të ndihmojë në pakësimin e numrit të vajzave që shesin trupin, ligji që ndalon ushtrimin e prostitucionit në Shqipëri ka nxitur rritjen e këtij numri. "Trafikantët shpëtojnë pa lagur nga proceset gjyqësore dhe, me të dalë nga dera e gjykatës, ata nxitojnë të rekrutojnë vajza të tjera, të cilat më pas i shesin si objekte. Ky ligj duhet ndërruar", thotë presë shkrimtarja Çuli, e cila shtoi se megjithatë shifra prej 30 mijë vajzash shqiptare në trotuarët e perëndimit është e ekzagjeruar.

Edhe më e zjarrtë u tregua, në një bisedë që patëm me të, Elsa Ballauri, kryetarja e Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut. Ajo mendonte që, në vend që të lihen midis dy zjarreve, atij të trafikimit dhe dënimit ligjor, këto vajza, të cilat do ta ushtronin prostitucionin në farëdolloj rrethane ligjore, për shkak të vështirësive ekonomike, do të ishte më mirë sikur të merreshin në mbrojtje.

"Eksperienca botërore tregon se legalizimi i këtij fenomeni e ka ndihmuar shoqërinë dhe vetë femrat e përfshira në prostitucion", tha Ballauri. Ajo u shpreh pro legalizimit të ushtrimit të prostitucionit në Shqipëri, sepse në radhë

të parë, kjo do të minimizonte mundësitë e trafikimit dhe do të ishte më e mundshme që të gjitha vajzat t'i nënshtroheshin një kontrolli të rreptë mjekësor. "Por, në fund të fundit, edhe shoqëria mbase do t'i pranonte më lehtë ato", mendon zonja Ballauri.

Por përveç atyre që janë pro dhe japin argumentet e tyre në favor të heqjes së ligjit që ndalon ushtrimin e prostitucionit në Shqipëri, në këtë debat ekziston edhe


Ervin Hatoi

